



Pranuar / Doretuar Punë/Prodato Received/Delivered	24.04.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3782/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.489/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.489/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Komunës së Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.04.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

*Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.489/2023 e datës 13.03.2023, e parashtruar nga ankues.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil \_\_\_\_\_ i punësuar në pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 13.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër reference 01-120/08-0013070-2/23 të datës 21.02.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurale si dhe diskriminimit në të drejtën e rimbursimit në formë retroaktive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( *tutje referuar vetëm Këshilli* ) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa, kjo e fundit më datë 13.04.2023 ka përcjell shkresat lidhur me këtë çështje ankimore.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2352/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër 01-120/08-0013010-2/23 të datës 21.02.2023 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; Ndryshim dhe Plotësimin e Aktit të emërimit nën shënjen AE.Nr.01-112/01-0106752/22 të datës 30.11.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 21.02.2023; Akt emërimit e datës 30.07.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Komunale e Transportit Rrugor; Vendimin me numër A.nr.864/2022 të datës 07.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2710/2023 të datës 15.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3541/2023 të datës 13.04.2023; Kërkuesen me numër të referencës 01-120/08-0013010/23 të datës 15.02.2023 për pagesë retroaktive; Listën e pagave për muajin Shkurt-2023; Listën e pagave për muajin Mars-2023;*

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike. I njëjti më datë 07.10.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjatë (6) në koeficientin tetë (8), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.873/2022 të datës 14.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut më datë 30.11.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimit AE.Nr.01-112/01-0106434/22 me koeficient tetë (8).

Ankuesi më datë 16.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së dy koeficienteve të pagës në mënyrë retroaktive që nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Republikës së Kosovës. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 21.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 16.02.2023 me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 21.02.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ankuesi me datë 13.03.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, po më bazë të njëjtë përkatësisht kompensimin retroaktiv të diferencës së dy koeficienteve të pagës në mënyrë retroaktive që nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 09.02.2013 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës *Inspektor i Shërbimeve Komunale* me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 05.10.2022,

duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 30.07.2012), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohet se: 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.489/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së

